

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues - gjyqtarin Artan Sejrani dhe gjyqtarët Fatmir Krasniqi e Vjollca Buzhala si anëtar të trupit, me procesmbajtësen Florije Kolukaj - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve O.A. nga Republika e Turqisë, për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 paragraf 1 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010, B.F. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 paragraf 2 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010, dhe N.N. nga Republika e Turqisë, për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 paragraf 1, 2 dhe 3 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010, sipas aktakuzave së Prokurorisë Speciale të Kosovës - PPS.nr.50/2011, PPS.nr.19/2013 të datave 11.12.2012, 11.09.2014 dhe 08.04.2016, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor duke vendosur mbi marrëveshjet për pranimin e fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës Paul Flynn, të akuzuarve, si dhe mbrojtësve të tyre av. E.R., av. H.K. dhe av. F.J., me datë 03.04.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. O.A. me nofkën "...", "...", dhe "...", nga i ati I... dhe e ëma M..., e vajzërisë ..., i lindur me dt. ... në ..., R. e Turqisë, me vendbanim të përkohshëm në ... në rr. "..." nr. ..., me numër të pasaportës Turke nr. ..., si dhe me numër të letërnjoftimit të R. së Kosovës nr. ..., i martuar, i ati i dy fëmijëve, pronar i restorantit, i gjendjes së mesme ekonomike, turk, shtetas i R. së Turqisë.

2. B.F., nga i ati F..., dhe e ëma Z..., e vajzërisë ..., i lindur me dt. ..., në fsh..., K. e ..., ku edhe tani jeton, me nr. personal ..., i martuar, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. N.N., nga i ati E..., dhe e ëma T..., e vajzërisë Yildiz, e lindur me ... në ..., R. e Turqisë, me vendbanim të përkohshëm në ..., me numër të pasaportës Turke nr. ..., si dhe me nr. personal ID ..., e pa martuar, tregtare, ka të kryer fakultetin e hotelierisë dhe turizmit, e gjendjes së mirë ekonomike, turke, shtetase e Republikës së Turqisë.

JANË FAJTOR

1. I akuzuari O.A.:

I. Së paku mes 1 tetorit 2011 dhe 17 nëntor 2011, O.A. në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale të krimit të organizuar, duke marrë pjesë në aktivitetet e grupit kriminal të përbërë nga O.A., B.F., A.C., N.A., "...", Sh.M., M.M., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A.B., S.A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T.H., M.B., D.S., A.S., E.S., M.M., R.A., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., N.K., I.(mbiemri nuk i dihet), E.(mbiemri nuk i dihet), A... (mbiemri i dihet), B...(mbiemri nuk dihet), personi me pseudonimin "...", dhe kryerësit tjerë të pa identifikuar, me qëllim që të përfitojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi dobi financiare ose dobi tjetër pasurore.

- Kësodore ka kryer veprën penale krim i organizuar nga neni 274 paragraf. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

II. Se në periudhën kohore prej tetorit 2010 deri me 26 mars 2011, ka kryer veprën penale të krimit të organizuar, ka kryer krim të rëndë, përkatësisht veprën penale kontrabandimi të migrantve, si pjesë e grupit të organizuar kriminal të përberë nga O.A., M.M., H.M., N.M., D.S., A.K., N.C., S.M., A.M., S.M., S.K., M.M., M.P., nje person i quajtur S..., nje person i quajtur E..., një person i quajtur E..., dhe disa kryerës tjerë të pa njohur, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

- Kësodore ka kryer veprën penale krim i organizuar nga neni 274 paragraf. 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

III. Të paktën mes 1 tetorit 2011 dhe 17 nëntorit 2011 O.A., në territorin e Kosovës, Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, ka kryer veprën e kontrabandimit të migrantëve përmes përfshirjes në kontrabandim, porositjen dhe sigurimin e dokumenteve mashtruese të udhëtimit ose të identifikimit për të mundësuar kontrabandimin për përfitim të dobisë financiare ose dobisë tjetër pasurore, dhe duke u mundësuar personave që nuk janë banor të Kosovës të hynë dhe të qëndrojnë në Kosovë, ose personave që nuk janë shtetas ose banor të përhershëm të kalojnë kufirin pa i plotësuar kushtet për hyrje të ligjshme, dhe qëndrim me mjete të cekura me parë ose me mjete të tjera, dhe më e rëndësishmja përmes organizimit dhe drejtimit të personave të tjerë që të kryejnë të njëjtat gjëra, për këta emigrant: (3) mes 1 tetorit 2011 dhe 7 tetorit 2011, ka kontrabanduar M.S., R.S.dhe A.(mbiemri i paraqitur si S...), shtetas të Turqisë, nga Turqia përmes Serbisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kroacisë për në Slloveni: (4) mes 1 tetorit 2011 dhe 17 nëntorit 2011, ka kontrabanduar Z. A. dhe O.Y., shtetas i Turqisë, nga Turqia për në Kosovës, pastaj nga Turqia përmes Kroacisë për në Itali.

- Kësodore ka kryer veprën penale kontrabandim i migrantëve nga neni 138 paragraf. 1,2,3,4,5 dhe 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

IV. Mes tetorit 2010 dhe Marsit 2011, O.A. ka bashkëpunuar në kontrabandim brenda territorit të Republikës së Sllovenisë, të shtetasve të huaj të cilët nuk kanë pasur leje për të hyrë ose për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë, me qëllim të kontrabandimit të mëtejshëm të këtyre migrantëve për në Itali:

- Me 8 tetorë 2010, M.M. ka trafikuar ilegalisht në territorin e Republikës së Sllovenisë, të paktën 4 shtetas të huaj Turq, të cilët nuk kanë pasur leje të futeshin e as nuk janë lejuar të qëndronin në Republikën e Sllovenisë, mirëpo ky e ka bërë këtë me qëllim që pastaj ti trafikonte ilegalisht në Republikën e Italisë;
- Mes datave 11 nëntor 2010 dhe 16 nëntor 2010, O.A. ka trafikuar ilegalisht 2 shtetas të huaj Turq, H.T. dhe B.K., brenda territorit të Republikës së Sllovenisë, shtetas të cilët nuk kanë pasur leje apo të futën apo të qëndrojnë në Republikën e Sllovenisë, me qëllim që pastaj ti trafikonte tutje neper shtetet anëtare të bashkimit evropian;
- Mes datave 25 nëntor 2010 dhe 26 nëntor 2010, O.A. ka tentuar që ilegalisht të trafikoj brenda territorit të Republikës së Sllovenisë dy shtetas të huaj Turq, M.B. dhe C.N., të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 29 nëntor 2010 dhe 8 dhjetorë 2010, O.A. ka trafikuar ilegalisht brenda territorit të Republikës së Sllovenisë dy shtetas të huaj Turq, B.M. dhe C. Y., të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 16 dhjetor 2010 dhe 17 dhjetor 2010, O.A. ka trafikuar ilegalisht brenda territorit të Republikës së Sllovenisë pesë shtetas të huaj Turqë A.B., T.B., D. B., G.B. dhe D. Z., dhe tre shtetas tjerë të huaj, të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 17 dhjetor 2010 dhe 29 dhjetor 2010, O.A. ka trafikuar ilegalisht brenda territorit të Republikës së Sllovenisë të paktën një shtetas të huaj i cili nuk kishte leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tij në Itali;
- Me 3 janar 2011, O.A. ka bashkëpunuar në trafikimin ilegal brenda territorit të Republikës së Sllovenisë, dy shtetas të huaj Turq U.V., dhe E.T. të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 10 janar 2011 dhe 14 janar 2011, O. A. ka bashkëpunuar në trafikimin ilegal brenda territorit të Republikës së Sllovenisë dy shtetas të huaj të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 6 mars 2011 dhe 9 mars 2011, O.A. ka bashkëpunuar në trafikimin ilegal brenda territorit të Republikës së Sllovenisë dy shtetas të huaj Turq, M.G. dhe S.Y., të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali;
- Mes datave 25 mars 2011 dhe 26 mars 2011, O.A. ka bashkëpunuar në trafikimin ilegal brenda territorit të Republikës së Sllovenisë të dy shtetasve të huaj të cilët nuk kishin leje për tu futur apo për të qëndruar në Republikën e Sllovenisë me qëllim të trafikimit ilegal të tyre në Itali.

- Kësodore ka kryer veprën penale kontrabandim i migrantëve nga neni 138 parag. 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

V. Në kuptim të nenit 363 parag. 1 nën parag. 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

- (i) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit, lokacionit, lëvizjes apo pronësisë së pronës;
- (ii) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të asistimit të personit, përkatësisht, O.A., B.F., A.C., N.A., "...", Sh.M., F.A., M.M., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A.B., S.A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T. H., M.B., D.S., A.S., E.S., M.M., R.A., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.H., J.Z., i njohur edhe si "...", N.K., I.(mbiemri i pa njohur), personin me nofkën "...", dhe anëtar të tjerë të pa identifikuar të grupit kriminal, të cilët janë të përfshirë me kryerjen e veprave penale që sollën pronat (kontrabandim me migrant për tu shmangur pasojave ligjore);
- (iii) Konvertimin apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të promovimit të aktivitetit kriminal të përmendur (kontrabandim me migrant), dhe apo
- (iv) Marrja, posedimi apo përdorimi i pronës (para të gatshme apo mjete të tjera monetare).

- Kësodore kishte për të kryer veprën penale nga neni 32 të ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010.

2. I akuzuari B.F.:

I. Së paku mes 1 tetorit 2011 dhe 17 nëntor 2011, B.F. në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale të krimit të organizuar, duke marrë pjesë në aktivitetet e grupit kriminal të përbërë nga O.A., B.F., A.C., N.A., "...", Sh.M., M.M., A.V., K.V., N. M., H.M., K.H., A.B., S.A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T.H., M.B., D.S., A.S., E.S., M. M, R.A., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M. I., H.H., N.K., I...(mbiemri nuk i dihet), E... (mbiemri nuk i dihet), A... (mbiemri i dihet), B...(mbiemri nuk dihet), personi me pseudonimin "...", dhe kryerësit të tjerë të pa identifikuar, në mënyre që të përvetësojnë drejtë për drejtë apo në mënyre të tërthortë dobi financiare apo pasurore.

- Kësodore ka kryer veprën penale krim i organizuar nga neni 274 parag. 2 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

II. Së paku gjatë periudhës nga data 1 tetor 2011 deri me datën 17. Nëntor 2011, B.F. në territorin e Kosovës, Serbisë, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, ka kryer veprën e kontrabandimit me migrant, duke u përfshirë në kontrabandim; duke siguruar dhe ofruar udhëtim apo dokumente identifikuese mashtruese për të mundësuar kontrabandimin për përfitime financiare apo dobi të tjera pasurore; dhe duke mundësuar personat të cilat nuk janë banor të Kosovës që të hynë apo qëndrojnë në Kosovë, apo personat të cilat nuk janë shtetas apo banor të përhershëm, të kalojnë kufirin duke shpërfillur kriteret e hyrjes së ligjshme, dhe të qëndrojnë në shtetin në fjalë pa i përfillur kërkesat e domosdoshme ligjore për qëndrim, në mënyrat e lartë cekura ose përmes mënyrave të tjera jo ligjore; dhe me e rëndësishmja, duke organizuar dhe udhëhequr personat të tjerë për të kryer të njëjtat vepra ndaj migrantëve në vijim: (3) gjatë periudhës nga data 1 tetor 2011 deri me datën 7 tetor 2011 duke kontrabanduar M.S., R.S. dhe A...(mbiemri i cekur si ...), qytetar Turq, nga Turqia përmes Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe

Kroacisë deri në Slloveni; (4) gjatë periudhës nga data 1 tetor deri me dtën 17 nëntor 2011 duke kontrabanduar Z.H. dhe O.Y., qytetar Turq nga Turqia për në Kosovë pastaj Turqi përmes Kroacisë dhe Sllovenisë në Itali.

- Kësodore ka kryer veprën penale kontrabandim i migrantëve nga neni 138 parag. 1, 2, 3, 5 dhe 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

III. Në kuptim të nenit 363 parag. 1 nën parag. 1.1 të KPP-së,

REFUZHET AKUZA

- (i) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit, lokacionit, lëvizjes apo pronësisë së pronës;
- (ii) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të asistimit të personit, përkatësisht, O.A., B.F., A.C., N.A., "...", Sh. M., F.A., M.M., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A.B., S.A. R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T.H., M. B., D. S., A.S., E.S., M.M., R.A., O.S., I.B., M.T., M. G., H.G., M.I., H.H., H.H., J.Z., i njohur edhe si "...", N.K., I. (mbiemri i pa njohur), personin me nofkën "...", dhe anëtar të tjerë të pa identifikuar të grupit kriminal, të cilët janë të përfshihër me kryerjen e veprave penale që sollën pronat (kontrabandim me migrant për tu shmangur pasojave ligjore;
- (iii) Konvertimin apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të promovimit të aktivitetit kriminal të përmendur (kontrabandim me migrant), dhe apo
- (iv) Marrja, posedimi apo përdorimi i pronës (para të gatshme apo mjete të tjera monetare).

- Kësodore kishte për të kryer veprën penale nga neni 32 të ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010.

3. E akuzuara N.N.:

I. Së paku në mes të korrikut dhe nëntorit të vitit 2012, N.N. në territorin e Kosovës dhe shteteve të tjera ka kryer veprën penale të kimit të organizuar duke: (1) organizuar, mbikëqyrur, menaxhuar, ose drejtuar aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga O.K., C.K., E.K., L.K., O.A., B.F., F.A.j, A.C., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., "...", Sh.M., M.M., S.I. M.C., S.P. – ..., M.M., I.H., M.H. (...), T.H., Sh. B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A. B., S. A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T.H., M.B., D.S., A.S., E.S., M.M., R.A., O.S., A.C., H.Y., M. O., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.H., J.Z.(...), N.K., I. (mbiemri i pa njohur), E.(mbiemri i pa njohur), A.(mbiemri i pa njohur), B. (mbiemri i pa njohur), person me pseudonimi "...", person me pseudonimin "...", pëson me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", pësoni me pseudonimin "...", dhe kryerës tjerë të paidentifikuar; (2) kryerja e kimit të rëndë respektivisht kontrabandim me migrant, si pjesë e O.A., B.F., F.A., A.C., M.B., A.M., A.B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., "...", Sh.M., M.M., S.I., M.C., S.P. – M., M.M., I.H., M.H. (...), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A.B., S.A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E.,

D.M., T.H., M.B., D.S., A.S., E.S., M.M., R.A., O.S., A.Q., I.Y., M.O., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H., H.H., J.Z. (...), N.K., I. (mbiemri i pa njohur), E. (mbiemri i pa njohur), A. (mbiemri i pa njohur), B. (mbiemri i pa njohur) person me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", pëson me pseudonimin "...", person me pseudonimin "...", dhe kryerës të tjerë të pa identifikuar dhe / ose (3) duke marrë pjesë në mënyre aktive në aktivitet kriminale dhe aktivitete tjera të grupit të organizuar kriminal të lartë përmendur duke ditur së pjesëmarrja e tyre do të kontribuonte në kryerjen e krimeve të rënda të lartë përmendura nga ana e grupit; me qëllim të përfitimit të drejtë për drejtë ose tërthorazi të dobisë financiare ose dobisë tjetër pasurore.

- Kësodore ka kryer veprën penale krim i organizuar nga neni 274 parag. 1, 2 dhe 3 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

II. Mes korrikut 2012 dhe nëntorit 2012, si vepër penale në vazhdimësi, Nuran Nar në territorin e Kosovës, Serbisë, ish Republikës jugosllave të Maqedonisë, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Gjermanisë dhe / ose shteteve të tjera ka kryer veprën penale kontrabandim me migrant duke u angazhuar në kontrabandim; duke siguruar dhe lëshuar dokumentet të rrejshme udhëtimi apo identifikimi me qëllim të përfitimit financiar apo përfitim tjetër material; dhe duke i mundësuar personave të cilët nuk ishin qytetar të Kosovës të hynë dhe të qëndrojnë në Kosovë, dhe personave të cilët nuk ishin shtetas apo banor me leje të përhershme të kalojnë kufijtë pa i plotësuar kushtet për hyrje të ligjshme të qëndrojnë në mënyra të përmendura me parë apo nga mënyra të tjera të jo ligjshme; dhe me rëndësi duke u organizuar dhe drejtuar personat te tjerë për kryerjen e veprave të njëjta, per migrantet në vijim:

- Në korrik 2012 kontrabandimi dhe / apo mundësimi i migrantëve I.Y., F.K. dhe M.S., të hyn dhe të qëndrojnë në shtetet e tjera, duke ia mundësuar hyrjen në Kosovë, dhe me pas duke organizuar transportin për në shtetin e caktuar.
- Në gusht 2012, kontrabandimi dhe / apo mundësimi i migrantëve O.Y., I.K., M.S. B., A.S., M.H. dhe S.B., të hynë dhe të qëndrojnë në shtetet të tjera, duke ia mundësuar hyrjen në Kosovë dhe me pas duke i organizuar transportin për në shtetin e caktuar.
- Në shtator 2012, kontrabandimi dhe / apo mundësimi i migrantëve M.G., R.K.G., T.Y., D.E., S.E., E.E., H.C., K.C., B.C., L.D., S.K., H.K., A.A., G.K., M.P., E.P., M.S.D., F.U., H.E., U.K., I.D., E.S., V.O., S.C., A.A., C.D., D.B., S.A., dhe M.K., të hynë dhe qëndrojnë në shtetet tjera, duke ia mundësuar hyrjen në Kosovë dhe me pas duke ia siguruar transportin për në shtetin e caktuar.
- Në tetor 2012, kontrabandimi dhe / apo mundësimi i migrantëve I.Y., C.C., E.B., N.S., V.A., H.Y., D.K., A.D.1, L.B., I.P., S.S., S.B., A.B., I.D., A.O., A.H.Y., T.E., H.S., A.A.1., A.A.2., F.G., A.D.2, H.M.K., O.G., O.K., A.U. dhe G.B., të hyn dhe qëndrojnë në shtetet e tjera duke ia mundësuar hyrjen në Kosovë dhe me pas duke ia siguruar transportin për në shtetin e caktuar.
- Në nëntor 2012, kontrabandimi dhe / apo mundësimi i migrantëve B.G., H.T., M.P., R.B., A.A., S.A., N.A., Y.A, D.A., C.K., N.C., M.M.B., A.G. dhe E.B., të hynë dhe qëndrojnë në shtetet e tjera duke ia mundësuar hyrjen në Kosovë dhe me pas duke ua siguruar organizuar transportin për në shtetin e caktuar.

- Kësodore ka kryer veprën penale kontrabandim i migrantëve nga neni 138 parag. 1, 2, 3, 5 dhe 6 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

III. Në kuptim të nenit 363 parag. 1 nën parag. 1.1 të KPP-së,

REFUZHET AKUZA

Ndërmjet 7 shkurt 2011 dhe 13 dhjetor 20112, N.N., në territorin e Kosovës dhe shteteve të tjera kanë kryer veprën penale të pastrimit të parave duke e ditur apo duke pasur shkak për të ditur se disa persona, respektivisht para të gatshme apo mjete të tjera monetare kanë origjinë të aktiviteteve kriminale dhe se në fakt burojnë nga vepra penale (kontrabandim me migrant nga ana e anëtarëve të grupit kriminal):

- (i) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit, lokacionit, lëvizjes apo pronësisë së pronës;
- (ii) Konvertimi apo transformimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të asistimit të personit, përkatësisht, O.A., B.F., F.A., A.C., M.B., A.M., A. B., I.P., M.A., S.S., A.G., T.Y., N.N., "...", Sh.M., M.M., S.I., M.C., S.P. – M., M.M., I.H., M.H. (...), T.H., Sh.B., N.P., Z.G., M.C., Z.M., G.N., A.V., K.V., N.M., H.M., K.H., A.B., S.A., R.V., G.B., A.A., A.B., B.E., D.M., T.H., M.B., D.S., A.S., E. S., M.M., R.A., O.S., A.C., H.Y., M.O., O.S., I.B., M.T., M.G., H.G., M.I., H.H.1., H.H.2., J.Z., " i njohur edhe si "...", N.K., I.(mbiemri i pa njohur), Esat (mbiemri i pa njohur), Avni (mbiemri i pa njohur), Bekim (mbiemri i pa njohur), personin me nofkën "...", pësoni me nofkën "...", personi me nofkën "...", personi me nofkën "...", personi me nofkën "...", dhe kryrës të tjerë të pa identifikuar të cilët janë të perfshihër në kryerjen e veprës penale që sollën pronën (kontrabandim me migrant) për tu shmangur pasojave ligjore;
- (iii) Konvertimi apo transferimi apo tentativa për të konvertuar apo transferuar pronën me qëllim të promovimit të aktivitetit kriminal të përmendur (kontrabandim me migrant), dhe apo
- (iv) Marrja, posedimi apo përdorimi i pronës (parat të gatshme apo mjete të tjera monetare).

- Kësodore kishte për të kryer veprën penale nga neni 32 të ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 6, 11, 15, 23, 31, 32, 33, 34, 36, 38, 39, 60,, 64, 67, 71, 274, 138, të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i:

GJYKON

1. Të akuzuarin **O.A.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.12.2011 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, po ashtu i shqipton edhe dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro.

2. Të akuzuarin **B.F.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 17.04.2011 deri me datën 22.08.2013 dhe nga data 26.02.2016 deri me datën 27.01.2017, po ashtu i shqiptohet edhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro.

3. Të akuzuarën **N.N.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) viteve, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 08.02.2013 deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, po ashtu i shqiptohet edhe dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro.

Në rast se të akuzuarit nuk mundën ose nuk dëshirojnë që ti paguajnë dënimet me gjobë, atëherë dënimet me gjobë do t'iu zëvendësohen në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do tiu llogaritet një ditë burgim.

Në kuptim të nenit 60 të KPK-së, të akuzuarve iu shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Nga të akuzuarit konfiskohen të gjithë telefonat celular dhe SIM kartelat të sekuestruar përkohësisht nga të akuzuarit e gjetur fajtorë dhe që është dëshmuar se janë përdorur për të kryer veprat penale.

Obligohen të akuzuarit O.A., B.F. dhe N.N., që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës, secili në shumën prej 300 (treqind) eurove, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Speciale e Kosovës, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzat PPS.nr.50/2011, PPS.nr.19/2013 të datave 11.12.2012, 11.09.2014 dhe 08.04.2016, kundër të akuzuarve O.A. nga Republika e Turqisë, për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 parag. 1 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010, B.F. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 parag. 2 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010, dhe N.N. nga Republika e Turqisë, për shkak të veprës penale krim i organizuar nga neni 274 parag. 1, 2 dhe 3 të KPK-së, veprës penale kontrabandimi me migrant nga neni 138 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të KPK-së dhe veprës penale nga neni 32 të Ligjit 03/L-196 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të datës 03.09.2010, i cili ka hy në fuqi me datën 18.10.2010.

Me aktvendimin e kësaj gjykate PKR.62/2016 të datës 15.02.2017, është bashkuar procedura penale kundër të akuzuarit O.A. me lëndën penale e cila ka qenë duke u udhëhequr në këtë gjykatë nën numrin PKR.nr. 4/2017.

Po ashtu Prokuroria Speciale e Kosovës, në gjykatë ka parashtruar marrëveshjet për pranimin e fajësisë PPS.nr.50/11 të datës 13.03.2017, respektivisht 03.03.2017, për të akuzuarit e lartpërmendur.

Gjykata, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar të akuzuarit, mbrojtësit e tyre si dhe Prokurorin e Prokurorisë Speciale lidhur me pretendimet e tyre sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Sa i përket gjendjes faktike gjykata e ka vërtetuar ashtu si është përcaktuar në dispozitivat e aktakuzave në kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Prokurorisë Speciale gjatë seancës ka deklaruar se gjyqtarët e nderuar e kanë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë para vetës, rrethanat dhe faktet mbi të cilat është arritur kjo marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë qëndrojnë dhe janë të shprehura në marrëveshje, zyra e prokurorisë beson se provat e mbledhura kundër të gjithë të akuzuarave të cilët janë të përfshirë në marrëveshje, në mënyrë shprehur më tërëqëse për fajësinë e të pandehurve me akuzat që ngarkohen dhe ata janë pajtuar në këtë fazë për provat me të cilat ngarkohen, përndryshe ata nuk do të hynin në marrëveshje për pranimin e fajësisë, të nderuar gjyqtar se në çdo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë prokuroria ka bërë rekomandime sa i përket dënimeve që duhen të zbatohen në rastin e të akuzuarve. Të akuzuarin O.A. prokuroria ka bërë një rekomandim me burgim prej 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj deri në 6 vite (gjashtë) vite burgim dhe në gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, pasi që O.A. ka qenë udhëheqës i grupit prandaj edhe e meriton një dënim më të gjatë. Sa i përket të akuzuarës N.N. prokuroria ka bërë një rekomandim me burgim prej 5 (pesë) viteve deri në 5 (pesë) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim, si një dënim i përgjithshëm së bashku me një gjobë prej 500 (pesëqind) euro, duke besuar se ky dënim dhe kjo gjobë reflekton dënimet për veprat që i ka kryer. Sa i përket të akuzuarit B.F. i cili ka bërë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë krimi i organizuar dhe kontrabandim me migrantë beson se ai ka më pak fajëse të tjerët dhe në këtë rast kanë rekomanduar dënimin 3 (tre) vite e deri në 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro. Prokuroria deklaroi se sa i përket të akuzuarit B.F. duke e marrë parasysh edhe kohën e gjatë që ai ka qëndruar në paraburgim që ti shqiptoj minimumin e dënimit të rekomanduar dhe njeherit t'ia pezulloj kohën e mbetur të burgimit gjë që e cila bie në vlerësim të trupit gjykues dhe se prokuroria nuk do ta kundërshtonte.

Mbrojtësi i të akuzuarit O.A., avokati H.R., ka deklaruar: se i mbrojturi i tij i akuzuari O.A. është akuzuari nga ana e prokurorisë speciale me prokuror të Eulex-it me një aktakuzë e cila ka shumë të meta, procedura penale ka filluar në bazë të një akti lutes nga R. e Sllovenisë, dhe në vend se prokuroria të veprojë në bazë të kësaj akti lutes ata kanë hapur hetimet kanë bërë përgjime dhe kanë ngritur aktakuzë, provat e ofruar në këtë. Aktakuzë janë transkriptet e telefonave, nuk kemi asnjë provë se kush janë këta persona dhe transkriptet telefonike nuk mund të shërbejnë si prova në procedurë, provat nga përgjimet mund të shërbejnë vetëm me parandalimin e ndonjë krimi ose terrorizmi. I akuzuari është qytetar i Turqisë dhe kjo procedurë ka mundur me filluar vetëm me miratimin e kryeprokurorit të shtetit, për këto arsye për mungesë të provave lënda dy herë është prishur. Prokuroria na ka ofruar material me metër por jo prova, duke e parë këtë situatë për rastin e njëjtë është ngritur edhe një aktakuzë, rreth 6 vite është në paraburgim përtej çdo norme,

dhe kjo ka qenë arsyeja për me hyrë në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe nuk mund të pret i mbrojturi im edhe 6 vite tjera për me qu drejtësinë në vend. Prandaj duke i pasur të gjitha këto kërkoj nga gjykata që ti shqiptohet minimumi i dënimit të paraparë me marrëveshjen e arritur.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.F. av. H.K., ka deklaruar se si mbrojtës i të akuzuarit B.F. bashkë me te kemi patur dy seanca negocimi me prokurorin e Eulex-it Mateus nga fakti se kemi shprehur gatishmërinë që në gjykimin e çështjes për të hyrë në negociim për shkak të rolit specifik i cili e ka patur i mbrojturi im B.F., dhe pas negociimit me dt. 01.02.2017, ka përfunduar me datën 08.03.2017, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë, për të cilën në tërësi e mbështesim pa vërejtje dhe se e njëjta është arritur pas lajmërimit të të mbrojturit tim, për etiketimin juridik të pranimit të fajësisë gjithashtu edhe pasojat mund ti këtë me pranimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje. Gjatë këtyre dy seancave kemi arritur me prokurorin mbi marrëveshjen për të ri kualifikuar veprën penale respektivisht në veprën penale nga neni 274 parag. 2 të krimit të organizuar dhe kontrabandimit me migrantë si që është ri cilësuar edhe në këtë marrëveshje, dhe se në këtë aspekt nuk kemi kurrfarë vërejtje, gjithashtu kemi pranuar propozimin për rekomandim për dënim ku në fakte gjykatës i rekomandohet prej 3 deri në 3 vite e gjysme, me dënim me burg dhe 500 (pesëqind) euro dënimin me gjobë, për të cilën edhe aty nuk kemi vërejtje, në seancën e sotëm dëgjova një deklaram të prokurorit i cili e përfaqëson këtë seancë dhe nëse e kamë kuptuar mirë tha se nuk do të kundërshton nëse gjykata i shqipton të mbrojturit tim dënimin për kohën e kaluar në paraburgim dhe dënimin e rekomanduar e që me siguri ia len në vlerësim trupit gjykues që ta pezullon dënimin në paraburgim në dënimin e shqiptuar.

Mbrojtësi i të akuzuarës N.N. av. F.J. ka deklaruar se fillimisht para se të sqarohem dhe deklarohem rreth pranimit të marrëveshjes së fajësisë me të mbrojturën time me lejoni që shumë shkurt do të shpreh të njëjtat shqetësime dhe brengat me gjithë ecurinë gjyqësore, e mbrojtura ime po ashtu vjen nga Turqia, duke theksuar se në tërësi solidarizohem me vërejtje dhe qortime të dhëna nga kolegu R. e cila pakënaqësi nga pikëpamja si mbrojtës nuk duhet të keqkuptohet me marrëveshje me fjalë për të cilën sot jemi tubuar në këtë shqyrtim gjyqësor. Përkitazi me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dëshiroj të theksoj se janë zhvilluar dy takime preliminare në prokurorin speciale në selinë e Eulex-it në Prishtinë ku kemi patur negociime mjaft konstruktive me prokurorin e çështjes dhe në fund kemi ra dakord me ofertën e prokurorit dëshiroj të theksoj se marrëveshja është arritur në tërësi duke respektuar dispozitën ligjore dhe atë piken 18 të nenit 233 të KPP-së, ku paraprakisht të mbrojturës time në tërësi e kamë sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimit të marrëveshjes mbi fajësinë dhe pas konsultimeve të duhura marrëveshja në fund është bërë me vullnetin e lirë dhe të pa ndikuar nga ana e të mbrojturës time, të cilën marrëveshje unë dhe e mbrojtura ime në tërësi e kemi pranuar dhe sot deklarojmë. Sa i përket dënimit të rekomanduar nga ana e prokurorit të çështjes unë përfitoj nga rasti të bëjë një lutje gjykatës që për hir të fakti para jush gjendet një femër, është treguar kooperative dhe konstruktive nga ana tjetër duke marrë parasysh se ka plane ambicioze për të filluar një jetë të re eventuale dhe sa më shpejtë të kthehet në gjirin familjar.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, lidhur me pranimin e fajësisë, sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, konstatoi se të akuzuarit e lartpërmendur, e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga të akuzuarit, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së, për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata ka konstatuar se marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë janë lidhur në pajtim me nenin 233 par. 18 të KPP-së dhe të njëjtat i ka pranuar.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit, të gjithë palët kanë deklaruar se qëndrojnë pranë dënimit të propozuar në marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve, formohen të gjitha elementet e qenies së veprave penale, të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit të i shpallë fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale-juridike të tyre.

Sa i përket dënimit, gjykata të akuzuarit i gjykoi me dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë tek të akuzuarit dhe në rrethin ku jetojnë, do të arrihet efekti i sanksionit penal që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese dhe se një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale për të akuzuarit.

Me rastin e caktimit të dënimit, llojit dhe lartësisë së tij, për të akuzuarit, gjykata e mori si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të njëjtit kanë pranuar fajësinë, kanë shprehur pendim të thellë dhe të sinqertë dhe kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime të tilla inkriminuese, janë familjarë, gjendjen e tyre ekonomike. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 34 të KPK, dhe se ky dënim, si i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, paragrafi 1 të KPPK-së.

Vendi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest civil është marrë në pajtim me nenin 463 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
PKR.nr.4/2017 me datë 03.04.2017

**Procesmbajtësja
Floriqe Kolukaj**

**Kryetari i trupit gjykues
Artan Sejrani**

UDHËZIM JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtën e ankesës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.